

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor

GJUHË SHQIPE

për klasën IV

Shkup, 2021

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	Gjuhë shqipe
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Klasa	IV (e katërt)
Tema/fusha programore	1. Gjuhë dhe komunikim 2. Letërsi dhe krijimtari 4. Njohuri mediatike dhe kulturë e medias
Numri i orëve	5 orë në javë / 180 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> • tablet, kompjuter; • tabelë e mençur; • lapustila (markera) shumëngjyrësh; • fletëza mësimore, plakate, afishe, ilustrime me figura (të ndara ose në varg) që kanë të bëjnë me përmbajtjet dhe veprimtaritë; • libra (me tregime, përrallëza, përralla, vjersha, gjëza, fjalë të urta) • revista për fëmijë, enciklopedi me ilustrime për fëmijët, fjalorë të ilustruar; • bibliotekë digjitale me libra; • bibliotekë me libra në klasë; • filma të animuar, regjistrime audio-vizuale shfaqjesh teatrale, softuerë mësimorë nga interneti dhe mjete të tjera audio-vizuale, si dhe mjete të tjera varësisht nga qëllimi mësimor.
Normativi për kuadrin mësimor	<p>Punën edukativo-arsimore për klasën e katërt mund ta zhvillojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • profesori/arsimtari/mësuesi i mësimit klasor; VII/1 ose VI/1 sipas KNK dhe 240 ECTS • pedagogu i diplomuar VII/1 ose VI/1 sipas KNK dhe 240 ECTS

NDËRLIDHJA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxënit që përmenden në programin mësimor shpjen në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën **Njohuri gjuhësore.**

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
I-A.1	t'i shprehë dhe t'i transmetojë mendimet, ndjenjat, informacionin dhe qëndrimet e veta në situata të ndryshme komunikimi në gjuhën e vet amtare, nëpërmjet medimeve të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme;
I-A.2	t'i njohë e t'i shfrytëzojë format e ndryshme të shprehjes me shkrim: ato letrare (vjersha, tregimi i shkurtër, prezantimi / të folurit, eseja (sprova) letrare, ditari etj.) dhe ato joletrare (eseja tematike, njoftimi, kërkesa, komunikata, reklama etj.);
I-A.3	të zhvillojë dialog kritik e konstruktiv duke i paraqitur qëndrimet e veta në mënyrë të argumentuar
I-A.4	të përdorë gjuhën standarde duke iu përmbajtur rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim;
I-A.6	të identifikojë veçoritë themelore të gjuhës amtare (alfabetin, historinë, dialektet etj.), si dhe ngjashmëritë e dallimet e saj me gjuhët e tjera;
I-A.8	të kuptojë përmbajtjen e mesazheve dëgjimore: të jetë në gjendje t'i shkëputë, t'i analizojë, t'i vlerësojë dhe t'i përmbledhë informacionet nga mesazhet dhe t'i shprehë ato (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.9	të kuptojë përmbajtjen e një teksti të shkruar: të jetë i aftë të veçojë, të analizojë, të vlerësojë dhe të përmbledhë informacionin nga teksti dhe ta shprehë atë (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.10	t'i kuptojë përmbajtjet e paraqitura vizualisht (diagrame, tabela e grafikë, ilustrime, filma vizatimorë etj.): të jetë në gjendje t'i ndajë, t'i analizojë, t'i çmojë/t'i vlerësojë dhe t'i përmbledhë përmbajtjet e shfaqura vizualisht dhe t'i sqarojë ato (me shkrim dhe me gojë);
I-A.11	t'i identifikojë e t'i analizojë mesazhet dhe elementet stilistike e estetike të veprave letrare;
I-A.12	të shfrytëzojë informacione nga burime dhe medime të ndryshme dhe t'u qaset atyre në mënyrë kritike, duke marrë parasysh burimin, kontekstin, qëllimin dhe besueshmërinë e informacioneve të paraqitura.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
I-B.1	nëpërmjet mësimin të gjuhës amtare zhvillohet identiteti i vet gjuhësor e kulturor, ndërsa nëpërmjet komunikimit gjuhësor përcillet trashëgimia kulturore dhe kultura e të jetuarit;
I-B.2	me përdorimin e gjuhës në kontekste e mjedise të ndryshme dhe në forma të ndryshme mundësohet komunikimi dhe ndërveprimi efikas (gjithmonë duke pasur parasysh se me kë bëhet komunikimi);
I-B.4	përmbajtja dhe mënyra e shprehjes së mendimit personal mund të kontribuojë për të mbajtur e për të përmirësuar komunikimin, por edhe të shkaktojnë mosmarrëveshje e konflikte;

I-B.6	njohja e gjuhës amtare paraqet themelin e të nxënit dhe përvetësimit të dijeve në të gjitha fushat e tjera (lëndët mësimore);
-------	---

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat relevante të këtyre fushave të Standardeve nacionale **Njohuri digjitale, Zhvillim personal dhe social, Kulturë shoqërore dhe demokratike dhe Të shprehurit artistik dhe kultura**

<i>Nxënësi /nxënësja di dhe mund:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë se për të zgjidhur një detyrë/problem kur dhe si është e nevojshme ta shfrytëzojë TIK-un në mënyrë efektive dhe efikase;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacionesh i duhen që t'i gjejë, t'i përzgjedhë dhe t'i shkarkojë të dhënat, informatat dhe përmbajtjet digjitale;
IV-A.7	të zgjedhë e të përdorë mjetet adekuate të TIK-ut për komunikim, të këmbëjë informacione në mënyrë të sigurt, të kontaktojë e të bashkëpunojnë me të tjerët në projekte online, në veprimtari sociale ose për nevojat e veta,
IV-A.8	t'i shfrytëzojë në mënyrë të sigurt e me përgjegjësi përmbajtjet digjitale, rrjetet arsimore e sociale dhe format digjitale,
IV-A.10	të ketë kujdes për identitetin, sigurinë dhe reputacionin e vet digjital dhe t'i përfillë politikat rreth privatësisë.
V-A.4	të bëjë vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të veta (duke përfshirë anët e fuqishme dhe anët e dobëta) dhe mbi këtë bazë t'i përcaktojë përparësitë që do t'ia mundësojnë atij / asaj të zhvillohet e të përparojë,
V-A.5	të njohë emocionet te vetvetja dhe te të tjerët, t'i kuptojë pasojat nga reagimet e veta emocionale në situata të ndryshme dhe të përdorë strategji përkatëse për t'u përballur me emocionet,
V-A.6	të përcaktojë qëllime të mësimit e të zhvillimit të vet dhe të punojë për kapërcimin e sfidave që i dalin para në rrugën e arritjes së tyre;
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale për ta lehtësuar mësimnxënien dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.10	të zbatojë parimet etike për të vlerësuar se ç'është e drejtë dhe ç'është gabuar në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të manifestojë vetitë e mira të karakterit (të tilla si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina),
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantojë veten në përshtatje me situatën,
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë adekuate, duke shprehur empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe t'i manifestojë në mënyrë konstruktive shqetësimet dhe nevojat e veta,
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke i pasur parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informacion prapaveprues (feed back) dhe përkrahje për vete, por edhe të japë informacion prapaveprues konstruktiv dhe përkrahje në dobi të të tjerëve;
V-A.19	të japë propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe të marrë vendime të arsyeshme;

VI-A.3	t'i formulojë e t'i argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë me vëmendje e t'i analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe të silllet me respekt ndaj tyre, madje edhe atëherë kur nuk pajtohet me to;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo qoftë baze (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi, status shoqëror etj.);
VI-A.6	të vërejë paraqitjen e stereotipave dhe paragjykimeve te vetja e te të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit;
VI-A.7	të vërejë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin që e rrethon, t'i kuptojë pasojat e dhunës dhe t'i kundërvihet asaj;
VII-A.9	të marrë pjesë aktive në punën ekipore sipas rregullave të miratuara paraprakisht dhe duke respektuar denjësisht rolin dhe ndihmesën e të gjithë anëtarëve të ekipit,
VIII-A.1	të tregojë se i njeh format e ndryshme të shprehjes artistike në të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.3	t'i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta duke shfrytëzuar format artistike ose format e tjera të të shprehurit krijues (individuale ose kolektive);
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në krijimet artistike të bëra nga të tjerët që janë pjesëtarë të kulturës së vet ose të kulturave të tjera;
VIII-A.5	të tregojë se e njeh kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, ndërtimeve dhe prodhimeve të tjera kulturore;
<i>Nxënësi /nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	njohuritë digjitale janë të domosdoshme në jetën e përditshme – ato e bëjnë më të lehtë të nxënit, jetën dhe punën, i japin ndihmesë zgjerimit të komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit dhe ofrojnë mundësi të ndryshme argëtimi;
IV-B.4	në hapësirën digjitale është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja e identitetit, e privatësisë dhe e sigurisë emocionale, të mos përdoret gjuha e urrejtjes e dhuna kibernetike dhe të përfillen rregullat e normat e komunikimit në komunitetet digjitale,
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij/e saj në masë të madhe varen nga puna që bën ai/ajo dhe nga rezultatet që i arrin ai/ajo;
V-B.4	çdo hap që ndërmerret është me pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/e saj;
V-B.7	marrja e iniciativës, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për kapërcimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'ia mundësojnë atij/asaj t'i përmbushë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij/e saj personale;
V-B.9	kërkimi i informacioneve prapavepruese dhe pranimi i kritikës konstruktive çon drejt përparimit në planin individual dhe shoqëror.

REZULTATET E TË NXËNIT

Fusha programore: **GJUHË DHE KOMUNIKIM**

Gjithsej: **80** orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të ritregojë përmbajtjen e teksteve dhe dialogëve të dëgjuar që kanë përmbajtje dhe gjatësi të ndryshme;
2. të diskutojë rreth një teme të caktuar pasi ka dëgjuar një tekst;
3. lexon rrjedhshëm me zë tekste stilesh të ndryshme funksionale dhe të ndryshëm për nga vështirësia e leximit, me një shpejtësi adekuate për moshën e vet;
4. të interpretojë të dhënat dhe ta shfrytëzojë informacionin e paraqitur në tekste joletrare;
5. të dallojë gjuhën popullore (dialektet) nga gjuha standarde shqipe;
6. të thurë tekste (me gojë dhe me shkrim) për nevoja të ndryshme komunikimi në gjuhë standarde duke përdorur fjalorin e nxënë dhe duke respektuar rregullat e miratuara gramatikore dhe drejtshkrimore.

Përmbajtjet (dhe konceptet):

- Dëgjimi i teksteve letrare dhe joletrare

Standardet për vlerësim:

- Veçon dhe vë në dukje fjalë e fraza kyçe të lidhura me idenë kryesore në tekstet letrare e joletrare (njoftime, udhëzime, ftesa, paralajmërime, reklama, përmbajtje audio e video për tema të ndryshme).
- Njeh, dallon dhe vë në dukje fakte e të dhëna të rëndësishme e të parëndësishme dhe përshkrime të njerëzve, të objekteve e të dukurive nga tekstet që ka dëgjuar.
- Riprodhon një tekst të shkurtër nga regjistrimet audio e video me përmbajtje të ndryshme dhe me fjalët e veta transmeton pjesë të përmbajtjes ose gjithë përmbajtjen, gojarisht dhe me shkrim.
- I vë re dhe i thotë se cilat janë elementet strukturore (hyrja, pjesa kryesore dhe përfundimi) ose kronologjike (fillimi, zhvillimi dhe mbarimi) të një tekst që ka dëgjuar dhe i përmend me radhë momentet kryesore sipas renditjes në përmbajtjen e tekstit.
- Thur një tekst në formë të folur dhe të shkruar sipas përmbajtjeve që ka dëgjuar, ku i përdor format gjuhësore përkatëse.

<ul style="list-style-type: none"> Dëgjimi dhe leximi i dialogëve për tema të ndryshme* <p>*temat duhet të harmonizohen me përmbajtjet e lëndëve të tjera, kryesisht të Shkencave natyrore dhe të Historisë e shoqërisë</p>	<ul style="list-style-type: none"> Bisedon në grup dhe zhvillon dialog pasi ka dëgjuar dhe pasi ka lexuar një temë. Përfshihet në bisedë pasi ka dëgjuar dhe pasi ka lexuar një temë. Nxit një bisedë pasi ka dëgjuar dhe pasi ka lexuar një temë. Harton një dialog në formë të shkruar, sipas dialogut që ka dëgjuar a që ka lexuar.
<ul style="list-style-type: none"> Simulim bisede për situata të komunikimit zyrtar dhe jozyrtar 	<ul style="list-style-type: none"> Vë në dukje rregullat e pranuar përgjithësisht dhe frazat gjuhësore përkatëse (sipas intonacionit të duhur) të komunikimit të kulturuar dhe i përdor ato në situata të ndryshme të jetës së përditshme – në bisedat e simuluar vihet me sukses në role të ndryshme.
<ul style="list-style-type: none"> Të shprehurit rreth një teme të caktuar ose rreth një teme me zgjedhje 	<ul style="list-style-type: none"> Tregon për përvojat dhe përjetimet e veta të ndryshme. Tregon gojarisht dhe me shkrim për një temë të caktuar ose për një temë të zgjedhur (nga tekstet shkencore-popullarizuese dhe publicistike ose që lidhen me përmbajtjet e përvetësuar në lëndët e tjera), duke përdorur fjalorin e duhur dhe rregullat gramatikore.
<ul style="list-style-type: none"> Leximi me zë dhe leximi pa zë 	<ul style="list-style-type: none"> Lexon me zë, rrjedhshëm dhe qartë në përputhje me moshën për lexim dhe atë gjuhësore. Lexon me zë në mënyrë shprehëse (në përputhje me llojin dhe natyrën e tekstit – vjershë, tregim i shkurtër, përrallëz, krijime dramatike, tekst gazete dhe tekste shkencore-popullarizuese). Lexon me zë në mënyrë shprehëse sipas intonacionit të fjalisë, d.m.th. i dallon shenjat e pikësimit dhe di t'i interpretojë ato “sipas zërit”. Lexon pa zë sipas kërkesave të drejtuara (p.sh. të nxjerrë informacione nga teksti).
<ul style="list-style-type: none"> Leximi dhe interpretimi i teksteve joletrare 	<ul style="list-style-type: none"> Përshkruan me fjalë të dhënat e paraqitura në grafikë, tabela, diagrame, në tekstet shkencore-popullarizuese dhe në informacion nga gazetat. Lidh kuptimin e përmbajtjes së lexuar me situata reale. Përdor citime dhe argumente nga një tekst i lexuar për të arsyetuar një qëndrim të caktuar.

<ul style="list-style-type: none"> Zotërimi i fjalëve të reja (sinonime, antonime) 	<ul style="list-style-type: none"> Përdor fjalë të reja në kontekstin përkatës. Grupon fjalët sipas fushës kuptimore të përdorimit. Shfrytëzon fjalorin digjital për të gjetur kuptimin e fjalëve të panjohura dhe të fjalëve me kuptim të njëjtë ose me kuptim të kundërt.
<ul style="list-style-type: none"> Dialektet e gjuhës shqipe kundrejt shqipes standarde (gegërishte, toskërishte) 	<ul style="list-style-type: none"> Dallon të folmen dialektore (gege dhe toske) nga një tekst i dëgjuar. Vë në dukje fjalët dhe shprehjet dialektore të përdorura më shpesh dhe i krahason ato me formën e tyre standarde dhe me formën në dialektet e tjera. Përmend së paku tri fjalë të urta /proverba në gjuhën popullore shqipe.
<ul style="list-style-type: none"> Ndarja e fjalëve në rrokje 	<ul style="list-style-type: none"> Njeh dhe vë në dukje fjalët me një rrokje, me dy rrokje dhe me tri rrokje. Di t'i ndajë fjalët në rrokje. I ndan si duhet fjalët në fund të rreshtit.
<ul style="list-style-type: none"> Emrat (<i>gjinia</i> dhe <i>numri</i>) Mbiemrat cilësorë Përemrat vetorë Foljet (<i>veta</i> dhe <i>koha</i>) 	<ul style="list-style-type: none"> E dallon dhe thotë se cilës gjini gramatikore i përkasin emrat që përmenden në shembujt e dhënë. Jep shembuj me emra në të tri gjinitë si në format e njëjës, ashtu dhe të shumës (pa bërë përkufizimin e tyre) Tregon emra të gjinisë asnjësore nga foljet. Thotë emra gjësensh, qeniesh e dukurish në gjininë dhe në numrin përkatës. Përmend fjalë që përdoren vetëm në numrin njëjës - emrat e përveçëm. Përdor mbiemrat cilësorë në gjininë dhe në numrin e duhur (pa përkufizim). Ndërton shprehje/togfjalësha me emra e mbiemra në gjininë e në numrin e duhur dhe togje të përbëra prej një emri e një mbiemri dhe një emri e dy mbiemrash. Përdor përemrat vetorë dhe disa forma të përemrave vetorë në të shprehurit me gojë dhe me shkrim. Përdor vetën e dytë shumës të përemrit vetor me format e tij në shenjë mirësjelljeje kur i drejtohet dikujt me gojë a me shkrim. E dallon dhe e vë në dukje vetën gramatikore gjatë dialogut dhe bisedës. Përdor trajtat foljore për të shprehur veprimet në kohën e tashme, në të shkuarën dhe në të ardhmen.

	<ul style="list-style-type: none"> • Përdor emrat, mbiemrat, përemrat vetorë dhe foljet gjatë të shprehurit me gojë e me shkrim, duke i lidhur në mënyrë logjike dhe sipas rregullave gramatikore në një kontekst fjali të dhënë.
<ul style="list-style-type: none"> • Llojet e fjalive sipas qëllimit të thënies (dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore dhe thirrmore) • Struktura e fjalisë 	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon llojet e ndryshme të intonacionit të fjalisë në shembujt me gojë dhe i shqipton fjalitë sipas intonacionit përkatës të tyre në shembujt që i lexon dhe që i ndërton vetë. • Ndërton lloje të ndryshme fjalish sipas nevojave të shprehjes. • Krijon fjali për funksionet e të dyja gjymtyrëve kryesore të fjalisë – për bartësin e veprimit dhe për vetë veprimin.
<ul style="list-style-type: none"> • Rregullat e drejtshkrimit (pika, dy pika, presje, thonjëza, pikëpyetje, pikëçuditje) 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërton fjali dhe kur shkruan i përdor shenjat përkatëse të pikësimit (kur i radhit e i përmend titujt, në llojet e ndryshme të fjalive). • E kupton se pika përdoret edhe si një shenjë drejtshkrimi (bie fjala, kur shkurtohen fjalët dhe kur shkruhen disa numërorë: etj., p.sh., d.m.th., f., 15.03.2021 ose 15.III.2021). • Shkruan fjalë dhe fjali duke iu përmbajtur rregullave për përdorimin e shkronjës së parë të madhe (te emrat e përveçëm, konceptet gjeografike, librat e revistat, adresat e institucionet).
<p>Shembuj veprimtarish:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësi lexon në mënyrë shprehëse një tekst letrar, kurse nxënësit udhëzohen të dëgjojnë me kujdes. Pastaj, në çifte, ata krijojnë nga një fjali që përmban thelbin e tekstit dhe secili e shkruan atë individualisht. Mandej secili çift paraqet fjalinë e vet dhe të gjithë së bashku (të udhëhequr nga mësimdhënësi) vlerësojnë fjalitë sipas asaj se sa mirë e pasqyrojnë thelbin e tekstit. • Nxënësit dëgjojnë parashikimin treditör të motit të incizuar (me ndryshime të mëdha temperature nga një ditë në tjetrën). Më pas mësimdhënësi i ndan nxënësit në tri grupe (grupi i parë – dita e parë, grupi i dytë – dita e dytë, grupi i tretë – dita e tretë) dhe e udhëzon secilin grup të përshkruajë (në një tekst të shkurtër) se si do të vishen në ditën konkrete sipas informacionit për motin. • Nxënësit dëgjojnë nga dy herë disa tekste të shkurtra për komunikim në një drejtim, d.m.th. një informacion që ata nuk mund dhe nuk duhet t'i përgjigjen, për shembull, njoftimi me zë në një qendër tregtare, në një stacion autobusi, në një palestër, në një teatër, në një aeroport etj. Mësimdhënësi i orienton nxënësit të regjistrojnë të dhënat që ata i konsiderojnë të rëndësishme, sepse më vonë do ta përsërisin informacionin në formën e tij autentike ose të modifikuar. • Mësimdhënësi organizon në klasë veprimtarinë – një vizitë te një bukëpjekës/-e, i cili/e cila tregon për profesionin e vet, lexon një recetë si gatuhet gjevrek, kurse nxënësit e ndjekin dhe nxjerrin të dhënat e nevojshme rreth përgatitjes së gjevrekut (mund të përdoret gjithashtu dhe një regjistrim video për recetën). Alternativa tjetër, mund të vijë mysafir në klasë një kuzhinier dhe të tregojë një recetë të thjeshtë për një vakt. 	

- Nxënësit dëgjojnë një përrallë popullore në gjuhën shqipe, kurse më pas, ndërkohë që disa prej tyre e ritregojnë me gojë, të gjithë shprehin përshtypjet e tyre me anë të një teksti të shkruar. Disa prej tyre e lexojnë atë që kanë shkruar para gjithë klasës.
- Nxënësit ndjekin shfaqjen edukative për fëmijë "Kafshët që jetojnë në fermë". Ata më pas flasin për përmbajtjen, përshkruajnë kafshët që jetojnë në fermë dhe diskutojnë rreth përfitimeve që kanë njerëzit nga rritja e këtyre kafshëve.
- Nxënësit dëgjojnë një material të incizuar nga emisionet për fëmijë rreth rregullave të komunikimit të kulturuar gjatë udhëtimit me autobus dhe gjatë vajtjes në ekskursion. Pastaj, ata luajnë rolin e shoferit dhe pasagjerit në autobus në situata të ndryshme, duke zbatuar rregullat e mirësjelljes (përsëritja, pyetja / përgjigja në heshtje, kërkimi i ndihmës etj.).
- Disa nxënës tregojnë për përvojat e tyre lidhur me lojërat në park, lojërat me dëborë, një fundjavë në fshat, një vizitë në teatër, pushime verore, festime, duke përdorur mbiemra së bashku me emrat. Nxënësit e tjerë, gjatë kohës që dëgjojnë, i shkruajnë emrat dhe mbiemrat që janë përdorur dhe më pas i lexojnë me zë dhe krahasojnë se cili prej tyre ka identifikuar më shumë emra / mbiemra.
- Loja me kapelë – p.sh. në shirita shkruhen fjali në të cilat ka emra dhe mbiemra. Shiritat palosen. Nxënësi merr një shirit dhe pasi e hap shiritin në fjalinë e dhënë, duhet t'i tregojë emrat ose mbiemrat që përdoren në fjali.
- Mësimdhënësi u shpërndan nxënësve kartela me fjalët kyçe për një temë të caktuar, p.sh. *Bukuritë e vendlindjes sime* (Vendbanimi im, Ngjashmëritë dhe ndryshimet me fqinjët e mi). Pastaj tre nxënës thonë nga një fjali ku do ta përdorin fjalën kyçe nga kartela që morën. Nxënësi i katërt i bashkon fjalitë e dëgjuara në një tekst sa të jetë e mundur më kuptimplotë. Procedura vazhdon me nxënësit e tjerë në klasë.
- Nxënësit dëgjojnë një regjistrim audio të një reklame për një produkt për fëmijë. Ata diskutojnë në çifte se për çfarë është reklama dhe më pas hartojnë një tekst të ngjashëm reklamimi për një produkt tjetër për fëmijë.
- Nxënësit marrin një tekst për ta lexuar dhe zhvillojnë lojën *Folësi i TV-së* duke u përpjekur të lexojnë rrjedhshëm dhe saktë. Gjatë kësaj loje mund të shfrytëzohen lloje të ndryshme tekstesh.
- Secili nxënës zgjedh tekstin që e ka parapëlqyer dhe e lexon atë në mënyrë shprehëse para të tjerëve gjatë orës.
- Nxënësit e lexojnë vetë një tekst ku përmbahen informacione për Ditën e Planetit Tokë, ndërsa mësimdhënësi u jep një listë të shkurtër me kërkesa për të nxjerrë informacione nga ai tekst. Pasi t'i lexojnë, nxënësit i këmbëjnë gojarisht informacionet e nxjerra nga teksti.
- Nxënësit lexojnë një shembull të tekstit joletrar - një tekst që përmban grafikë të temperaturave të mëngjesit gjatë një jave të muajit. I analizojnë të dhënat dhe nxjerrin përfundimet që do t'i prezantojnë (nëse temperaturat rriten, ulen ose mbeten të njëjta).
- Nxënësit lexojnë një tekst të shkurtër që përmban të dhëna të paraqitura në diagrame lidhur me atë se sa fëmijë ngasin motorolerë, sa ngasin biçikleta dhe sa trotinete, pastaj bëjnë analizë në çifte dhe i prezantojnë të dhënat.
- Nxënësit lexojnë tekste për sigurinë në trafik, të përgatitura dhe të përshtatura nga mësimdhënësi. Secili prej tyre zgjedh tri rregulla që i konsideron si më të rëndësishme dhe ato i ilustron.
- Nxënësit diskutojnë në çifte për përmbajtjen e një teksti të lexuar. Mësimdhënësi shkruan në dërrasë pyetjen kyçe për kuptimin e tekstit dhe zbaton teknikën e debatit. Çdonjëri duhet të mendojë vetë nëse është PËR, KUNDËR ose I PËRMBAJTUR. Pastaj secili e argumentojnë qëndrimin e vet me një fjali duke iu përgjigjur pyetjes se PSE mendon ashtu.

- Mësimdhënësi lexon një tekst të shkurtër për temën e ekologjisë, ku përdoren disa fjalë të panjohura për nxënësit. Nxënësit i vënë në dukje fjalët e panjohura dhe përpiqen të shpjegojnë kuptimin e tyre nëpërmjet kontekstit ku përdoren. Mësimdhënësi ua thotë kuptimin që kanë ato fjalë në fjalor. Pastaj nxënësit sajojnë fjali të reja ku i përdorin ato fjalë në një kontekst të ri.
- Pas ndjekjes së një teksti me karakter informues, nxënësit i shkruajnë fjalët e panjohura dhe i kërkojnë ato në fjalorin digjital. Në fund ata paraqesin kuptimin e fjalëve të panjohura.
- Nxënësit lexojnë një tekst në formën dialektore (nga gegërishtja qendrore dhe nga toskërishtja veriore) dhe më pas, të ndarë në çifte, diskutojnë për fjalët që ata mendojnë se janë të ndryshme nga forma standarde. Secili çift paraqet shembullin/-jt e vet.
- Nxënësit luajnë role, për shembull, shitësi dhe blerësi (Si flasim në treg) ku njëri prej bashkëbiseduesve përdor gjuhën dialektore.
- Nxënësit dëgjojnë një tekst të shkurtër të incizuar (p.sh. një përrallë popullore shqipe), ku përdoren format dialektore geqe dhe toske. Derisa e dëgjojnë tekstin të gjithë shkruajnë fjalët/shprehjet që kanë identifikuar sipas dialektit. Pastaj, në grupe, ata bashkojnë të gjitha fjalët/shprehjet dialektore të dëguara dhe i kthejnë ato në gjuhën standarde shqipe. Secili grup paraqet 1-2 nga fjalët/shprehjet e identifikuar.
- Mësimdhënësi thotë fjalë dhe kërkon nga nxënësit që ato t'i klasifikojnë në tabelë si: fjalë me një rrokje, me dy rrokje dhe me tri rrokje. Nxënësit më pas bëjnë ndarjen e fjalëve në rrokje dhe shpjegojnë strukturën e tyre, nga cilët tinguj janë të përbëra.
- Fjalori me katër kënde – Nxënësit palosin një fletë për së gjati e për së gjeri (d.m.th. që të krijohen katër fusha – dy rreshta dhe dy kolona). Në katrorin e majtë lart shënohet fjala e panjohur. Në katrorin e majtë poshtë shënohet fjalia origjinale ku u përdor fjala e panjohur. Në katrorin e djathtë lart vizatohet një figurë me të cilën vizualizohet fjala e panjohur. Në katrorin e djathtë poshtë shkruhet fjala e panjohur në një fjali në kontekstin e ri.
- Nxënësit dëgjojnë tekste me një numër të madh emrash në të tria gjinitë, në numrin njëjës dhe shumës. Pasi të identifikohen, ato i klasifikojnë sipas gjinisë dhe sipas numrit.
- Mësimdhënësi vizaton në dërrasë një tabelë me tri kolona të emërtuara me fjalët: gjinia mashkullore, gjinia femërore dhe gjinia asnjënjësore. Më pas, secili nxënës shkruan një emër në kolonën përkatëse. Në fund mësimdhënësi lexon emrat e shkruar në secilën kolonë dhe të gjithë diskutojnë pse janë shkruar pikërisht në atë kolonë. (Diskutimi ka të bëjë me fjalët në titujt e kolonave.)
- Nxënësit të ndarë në grupe krijojnë një "rrjetë merimange" nga emrat e identifikuar në një tekst të caktuar sipas gjinisë dhe numrit të tyre. Çdo ndarje e rrjetës i përket një kategorie gramatikore (gjinia mashkullore, femërore, asnjënjësore; numri njëjës, numri shumës). Pasi identifikohen emrat në tekst, ata vendosen në ndarjet përkatëse të rrjetit.
- Nxënësit janë të ndarë në katër grupe "ekspertësh". Të gjitha grupet marrin tekstin e njëjtë. Secili grup e analizon tekstin nga një aspekt i caktuar: grupi 1 - përcaktimi i gjinisë dhe numrit të emrave në tekst, grupi 2 - përcaktimi i numrit dhe gjinisë së mbiemrave në tekst, grupi 3 - identifikimi i përemrave vetorë në tekst dhe grupi 4 - përcaktimi i foljeve në tekst sipas vetës dhe numrit. Pastaj, nxënësit nga këto grupe rishpërndahen në grupe të reja, në mënyrë të tillë që në secilin grup të ri të ketë një përfaqësues nga këto katër grupe. Grupet e riformuara punojnë në të gjithë tekstin, në një mënyrë të tillë që çdo grup u prezanton të tjerëve se çfarë ka bërë grupi i tij "ekspert".
- Nxënësit ndahen në grupe. Mësimdhënësi organizon një kuiz sipas kërkesave të mëposhtme: 1. "Thuaj përgjigjen e saktë", ku secili grup ka për detyrë të thotë një emër të përgjithshëm dhe një të përveçëm (kërkesat mund të vështirësohen). 2. "Ne tashmë e dimë mirë këtë", ku

secili grup shkruan një emër të përveçëm, një të përgjithshëm dhe një mbiemër.

- Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup ka për detyrë të shkruajë fjali me pesë emra të përgjithshëm dhe pesë emra të përveçëm sipas zgjedhjes së tyre. Pastaj i lexojnë me zë.
- Nxënësit punojnë në çifte: njëri nxënës thotë një emër dhe tjetri një mbiemër, pastaj ndërrojnë rolet. Nxënësit shkruajnë shembujt dhe ua paraqesin shokëve të tyre të klasës (p.sh. *bluzë - e kuqe, leshi, e ngushtë, e gjerë, e vogël, e madhe, e bukur ...*).
- Nxënësit japin individualisht shembuj të krijimeve me emra dhe mbiemra dhe më pas i shkruajnë ata në një tabelë dhe i grupojnë sipas gjinisë dhe numrit (karrige - e madhe, e gjelbër; top – i larmë, i bardhë; pulë - e zezë, e vogël).
- Nxënësit luajnë lojën "*Përshkruaj objektin*". Një nxënës shkruan në tabelë një gjësend nga klasa (emër). Nxënësit e tjerë përshkruajnë cilësinë e emrit të zgjedhur me anë të mbiemrave, kurse nxënësi tjetër shkruan në dërrasë mbiemrat rreth emrit. Procedura përsëritet për emra të tjerë me nxënës të tjerë.
- Nxënësit luajnë lojën "*Gjeje çka është, gjeje kush është*": Nxënësit në grupe shkruajnë një gjësend, një kafshë ose një bimë dhe disa mbiemra për ta përshkruar atë. Atëherë i tregojnë vetëm mbiemrat (njëri pas tjetrit) dhe nxënësit nga grupet e tjera e mendojnë gjësendin / kafshën / bimën nëpërmjet paraqitjes së përshkrimit të dëgjuar. Procedura përsëritet për secilin grup.
- Nxënësit marrin një fletë pune me ilustrime të pemëve dhe perimeve. Nën secilën fotografi ata shkruajnë vetitë e tyre, pra mbiemrat që përshkruajnë emrat.
- Nxënësit në fletën e punës i plotësojnë vendet e zbrazëta në fjali më të gjata ku mungon emri (i përveçëm ose i përgjithshëm) ose mbiemri.
- Nxënësit ndjekin një dialog të paraqitur në formë stripi me heronj të famshëm. Ata më pas e ritregojnë atë, duke përdorur përemrat vector në vend të emrave të personazheve.
- Nxënësit lexojnë bashkëbisedime/fjali ku përdoren përemrat vectorë dhe format e përemrave vectorë, kurse më pas krijojnë shembujt e tyre sipas analogjisë: *Teuta sheh Andën - Ajo e sheh atë; Mësimdhënësi i flet Gentit - Ai i flet atij.*
- Nxënësit bashkëbisedojnë dhe përdorin përemrat vectorë në vetën e tretë në vend të emrave të përveçëm dhe të përgjithshme: *Jepja Albës lapsin - Jepja asaj lapsin; Thuaji të mos e marrë librin - Thuaji të mos e marrë atë.*
- Nxënësit kanë për detyrë të hartojnë dialogë me hapësira të zbrazëta që duhet të plotësohen me përemrat vectorë dhe format e përemrave vectorë (në rasa, në numër...)
- Secili nxënës mendon një folje që i referohet të bërit punë në një profesion dhe e shkruan atë në një copë letër. Pastaj të gjitha copëzat e letrës vendosen në një grumbull dhe përzihen. Secili nxënës tërheq një copë letër nga grumbulli (nxënësi prezanton foljen dhe thotë se cilit profesion i referohet). Me foljen përkatëse nxënësi formon një fjali.
- Nxënësit përcaktojnë kohën e veprimit të foljes në shembujt e theksuar nga mësimdhënësi përmes lojës për përcaktimin e veprimit të foljes "Dje-sot-nesër".
- Mësimdhënësi vizaton në dërrasë një tabelë me tri kolona, në të cilat shënohen pyetje: Çfarë ke bërë dje? Çfarë po bën tani? Çfarë do të bësh nesër? Nxënësit u përgjigjen me shkrim pyetjeve dhe përcaktojnë kohën e foljes.
- Shfrytëzojnë folje në të tri kohët e foljes (e shkuara, e tashmja, e ardhmja). Mësimdhënësi shkruan fjalët *dje* (koha e shkuar), *sot* (koha e tashme), *nesër* (koha e ardhme). Nxënësit thonë trajta foljore në kohën e shkuar, në të tashmen e në të ardhmen dhe i shkruajnë ato nën

fjalët që përshtaten me kohën e veprimit të foljes.

- Nxënësit punojnë në çifte - shkruajnë fjali me foljet e dhëna. Mësimdhënësi i udhëzon ata që shembujt t'i shkruajnë në kohën e tashme, dhe pastaj t'i kthejnë në kohën e shkuar dhe në kohën e ardhme. Përmenden shembuj me folje që u përkasin të tri zgjedhimeve: duhet të tregohet kujdes gjatë përdorimit të foljeve në kohën e pakryer dhe në kohën e kryer të thjeshtë, mbaresat *-ja* dhe *-va*.
- Nxënësit marrin nga një letër me emra, mbiemra dhe folje. Ata hapin aplikacionin nga faqja në storyjumper dhe fusin emrat dhe mbiemrat në të, të cilat kanë për detyrë t'i lidhin me figura dhe ilustrime që shfaqen si mundësi. Hartojnë një tekst të shkurtër duke përdorur fjalët e krijuara. Nga kjo veprimtari krijohet *libri i klasës*.
- Nxënësve u jepen ilustrime të ndryshme (një person që i dhemb dhëmbi, një fëmijë që fryn një qiri dhe imagjimon një dëshirë, një person që kollitet dhe kërkon ujë, një fëmijë që pret të hapë një dhuratë ...) dhe krijojnë lloje të ndryshme fjalish (dëftore, nxitëse, pyetëse) në përputhje me ilustrimin.
- Nxënësit shkruajnë shembuj fjalish me të cilat do të shprehin: befasi, urdhër, pyetje ose të tregojnë diçka.
- Nxënësit i bashkojnë fjalët e dy kolonave, në njërën kolonë janë fjalët pyetëse *kush*, *ku*, *çfarë*, *pse*, kurse në kolonën tjetër janë disa fjalë ose pjesë të një fjalie që janë përgjigjet e tyre (p.sh. *Kush?* – Kastrioti; *Ku?* – te Blerta; *Pse?* - Diana tha kështu; *Çfarë?* - spinaq).
- Nga një enë nxënësit marrin një copë letër ku janë shkruar foljet për të krijuar fjali me to. Pasi të kenë krijuar fjalitë, zgjedhojnë foljen nëpër veta.
- Nxënësit i bashkojnë fjalët e dy kolonave, në njërën kolonë janë bartësit e veprimit, kurse në kolonën tjetër janë veprimet. Nxënësit i thonë gojarisht fjalitë e përgatitura dhe e plotësojnë njëri-tjetrin.
- Nxënësit lexojnë një tekst ku mungojnë shenjat e pikësimit. Pasi vendosin shenjat e duhura të pikësimit, lexojnë tekstin sipas intonacionit përkatës për secilën fjali.
- Loja "*Gjeografia e shpejtë*". Nxënësit janë të ndarë në grupe dhe secili grup ka për detyrë të shkruajë emrin e vendit, fshatit, qytetit, lumit, liqenit, detit me shkronjën e përcaktuar... Nxënësit kontrollojnë njëri-tjetrin nëse emërtimet gjeografike dhe emrat e përveçëm i kanë shkruar me shkronjën e parë të madhe.
- Loja "*Korrigjo gabimet*": Nxënësit ndahen në çifte; secili çift merr një fletë pune me shembuj ku shkronja e madhe është përdorur gabimisht. Secili çift korrigjon fjalët e shkruara gabimisht dhe këtë gjë e prezanton.
- Nxënësit në grupe të vogla zbulojnë fjalë të shkruara gabimisht, jo sipas rregullave për përdorimin e shkronjës së madhe dhe thonjëzave në një tekst të caktuar (emrat dhe mbiemrat, adresat e banimit, emrat e institucioneve, titujt e librave dhe revistave).

Fusha programore: **LETËRSI DHE KRIJIMTARI**

Gjithsej: **90 orë**

Rezultatet e të nxënësve:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të bëjë dallimin e krijimeve letrare dhe t'i shpjegojë dallimet midis tyre;

<p>2. të analizojë e të interpretojë një tekst letrar në nivel të përmbajtjes dhe të përdorë citimet për ta mbështetur analizën;</p> <p>3. të ritregojë tekste letrare, të tregojë ngjarje (me gojë e me shkrim) dhe të krijojë tekste rreth një teme të caktuar ose të lirë.</p>	
<p>Përmbajtjet (dhe konceptet):</p> <ul style="list-style-type: none"> Leximi dhe interpretimi i teksteve letrare (tregim i shkurtër, përrallë, përrallëz, tregim, krijime poetike e dramatike) Krijimtaria gojore popullore (gjëzat, fjalët e urta, përgëzimet, uratat) 	<p>Standardet për vlerësim:</p> <ul style="list-style-type: none"> Identifikon se cilit lloj letrar i takon një tekst (përrallëz, tregim i shkurtër, përrallë, tregim, krijime poetike e dramatike). I gjen dhe i shpjegon ngjashmëritë dhe dallimet midis teksteve letrare (me anë të ngjarjeve dhe personazheve). Ritregon (me gojë dhe me shkrim) një tekst letrar në tërësi ose pjesë-pjesë U përgjigjet pyetjeve dhe bën pyetje rreth përmbajtjes së ndonjë teksti letrar të lexuar. Përcakton temën, personazhet, vendin dhe radhitjen kronologjike të ngjarjes në një tekst letrar të lexuar. Dallon elementet reale dhe ato fantastike (ngjarje e personazhe) në një tekst të lexuar. Përcakton vargun, strofën dhe rimën te një krijim poetik /vjershtë. Riprodhon krijime nga krijimtaria gojore popullore dhe e thotë domethënien e tyre. I gjen citimet në tekstin e dhënë sipas një kërkesë/pyetje konkrete (pamja e personazhit, veprimi, përshkrimi, ngjarja). Përmend citimet nga teksti për ta ilustruar personazhin, veprimin, përjetimin, ngjarjen që pasqyrohet në tekst.
<ul style="list-style-type: none"> Përshkrimi, tregimi dhe krijimi i teksteve të shkurtra 	<ul style="list-style-type: none"> Përshkruan (me gojë dhe me shkrim) personalitete, peizazhe dhe dukuri pas vëzhgimit dhe pas përjetimit. Tregon (me gojë dhe me shkrim) ngjarje të përfytyruara ose të përjetuara. Tregon duke ndryshuar vetën gramatikore. Tregon duke e ndryshuar përfundimin e një përmbajtje të lexuar. Shkruan tekste me strukturë të thjeshtë kompozicioni për një temë të caktuar ose të lirë.

Shembuj veprimtarish:

- Nxënësit ndahen në grupe dhe çdo grup merr nga një tekst të ndryshëm për nga lloji letrar: vjershë, përrallëz, tregim i shkurtër, pjesë teatrale njëaktëshe. Bisedohet në grupe dhe krahasohen tekstet sipas formës në të cilën janë shkruar (bie fjala, krijimin në vargje dhe tregimin e dallojnë nga ajo se sa është e mbushur fleta me tekst, ndërsa pjesën njëaktëshe e dallojnë sipas fjalëve të personazheve që janë të ndara.
- Nxënësit lexojnë një vjershë dhe një përrallëz dhe i analizojnë me ndihmën e tabelës-T numërojnë: nga njëra anë e tabelës-T shënojnë sa strofa ka vjersha, sa vargje ka në secilën strofë, a ka rimë, kurse në anën tjetër të tabelës-T nxënësit shënojnë sa rreshta është teksti i përrallëzës, cilët janë personazhet dhe çfarë qeniesh janë ata. Më pas, prezantojnë ato që kanë shënuar dhe krahasojnë karakteristikat e tyre.
- Nxënësit lexojnë një përrallë dhe pastaj e ritregojnë pjesën më të pëlqyer të saj, ose e ritregojnë atë në tërësi.
- Nxënësit lexojnë një tekst. Pastaj shkruajnë në fletë nga një ose më shumë pyetje që lidhen me përmbajtjen e tij. Që të mos përsëriten shumë pyetje të njëjta, nxënësit ndahen në disa grupe sipas tipit të pyetjeve që duhet t'i parashtrojnë – pyetje me *po/jo*, pyetje me *kush, çfarë, kur, si, pra*, me cilën fjalë pyetëse do të fillojnë pyetjet. Fletëzat i futin në një enë qelqi, pastaj të gjithë tërheqin nga një pyetje, e lexojnë atë me zë dhe bashkërisht i përgjigjen.
- Nxënësit të ndarë në grupe lexojnë një tekst, ku janë përshkruar më shumë ngjarje që ndodhin njëra pas tjetrës. Më pas e përcaktojnë atë dhe shkruajnë radhitjen kronologjike të ngjarjeve me numërim. Në fund të gjithë e lexojnë atë që kanë shkruar dhe përcaktojnë se sa saktë e kanë bërë radhitjen e ngjarjeve.
- Nxënësit lexojnë një tregim. Pastaj të ndarë në grupe marrin tekstin e tregimit të ndarë në disa pjesë (fletëza të veçanta) sipas ngjarjeve që përmban. Nxënësit së pari rregullojnë fletët e punës sipas radhës së ngjarjeve në tregim e më pas marrin detyrë të ndryshojnë radhitjen e disa prej ngjarjeve në një mënyrë që ka kuptim për ta. Në fund, secili grup lexon tekstin e ri dhe shpjegon se çfarë është arritur me ndryshimin e radhitjes së ngjarjeve.
- Mësimdhënësi shkruan në tabelë një citim të nxjerrë nga një tekst letrar dhe nxënësit së bashku e analizojnë dhe e interpretojnë përmbajtjen/ mesazhin e tij. Më pas, mësimdhënësi shkruan një tjetër citim nga i njëjti tekst, ndërsa secili nxënës shkruan atë që ka kuptuar nga citimi. Në fund, disa nga nxënësit lexojnë atë që kanë shkruar dhe kështu zhvillohet një diskutim i përbashkët.
- Nxënësit janë ndarë në grupe dhe secili grup merr kartela me fjalët kyçe të një tregimi (që kanë të bëjnë me kohën dhe vendin e ndodhjes së ngjarjes) me detyrë që derisa e lexojnë tregimin, t'i kushtuar vëmendje fjalëve kyçe. Pas leximit ata komentojnë kuptimin e çdo fjale të kartelës dhe i lidhin ato me tërësinë kuptimore.
- Nxënësit lexojnë një tekst letrar. Gjatë leximit ata e gjejnë kohën, vendin dhe ambientin ku zhvillohet ngjarja dhe nënvizojnë tekstin që tregon për to. Pjesët e nënvizuara, në formë të citimeve nga teksti i këmbejnë nëpërmjet prezantimeve me gojë dhe i krahasojnë ato.
- Nxënësit lexojnë një tregim, kurse pastaj u përgjigjen: a) pyetjeve për përmbajtjen e tekstit që e përcakton temën; b) pyetjeve për llojin e tekstit (realist ose fantastik). Për pohimet e veta duhet të sigurojnë nga tri dëshmi (citime) prej tekstit, domethënë, të tregojnë se ku saktësisht në tekst e gjetën përgjigjen.

- Nxënësit lexojnë vjersha në grupe dhe bisedojnë për strukturën e vjershës së lexuar: strofa dhe vargjet, kurse pastaj në mënyrë të pavarur i ndajnë fjalët që përputhen në pikëpamje tingullore.
- Nxënësit e dëgjojnë leximin interpretues të vjershës, duke qenë të udhëzuar prej përpara që ta përqendrojnë vëmendjen në mënyrën e spikatjes së disa pjesëve në tekst, kurse më pas bisedojnë në klasë për këto fjalë të spikatura për nga tingëllimi që përputhen mes vete dhe për mënyrat se si është arritur kjo gjë.
- Nxënësit lexojnë një krijim poetik, përcaktojnë rimat dhe me to pastaj krijojnë shembujt e vet duke shkruar një krijim të vogël poetik.
- Nxënësit bëjnë lojën *Mjaltë nga "Bleta shqiptare"*, mësimdhënësi përgatit tekste të shkurtra folklorike, ndërsa nxënësit i lexojnë, interpretojnë kuptimin e tyre dhe zgjedhin disa për dramalizim.
- Nxënësit lexojnë një tregim dhe i përcaktojnë personazhet e tij. Mandej zgjedhin një nga personazhet dhe gjejnë citime nëpërmjet të cilëve përshkruhen vetitë e personazhit dhe veprimet e tij dhe më pas komentojnë për përshtatshmërinë e tyre.
- Nxënësit lexojnë vetë një tregim, titullin e së cilës nuk e dinë, më pas marrin detyrë për të gjetur një titull bazuar në përmbajtjen e tregimit.
- Nxënësit lexojnë vetë një pjesë teatrale njëaktëshe, kurse pastaj bëjnë përshkrimin/shpjegimin e veprimit të ndonjërit prej personazheve të tekstit duke e vënë veten në vendin e tij.
- Nxënësi e lexon një tekst (prozë, vjershë a pjesë njëaktëshe). Gjatë leximit shfrytëzon teknikën *Ditari me hyrje të dyfishtë*, shkruan një citim nga teksti që i referohet përshkrimit të një personazhi, një veprimi ose një ngjarjeje dhe e përshkruan atë si e ka përjetuar.
- Ndahen nxënësit në grupe, lexojnë një tekst dhe u përgjigjen këtyre kërkesave të shtruara prej përpara nga ana e mësimdhënësit: të ritregojnë shkurtë përmbajtjen e tekstit, të përcaktojnë temën për të cilën bëhet fjalë dhe të përcaktojnë ngjarjen kryesore. Ngjarjen kryesore nxënësit e lidhin me ndonjë nga përvojat e veta dhe diskutojnë brenda grupit. Secili grup bën prezantimin e shkurtër të punës dhe diskutimit të vet.
- Me ndihmën e mësimdhënësit nxënësit bëjnë një përmbledhje të asaj që kanë parë gjatë shëtitjes së fundit/piknikut të përbashkët njëditor diku në afërsi, i shkruajnë pesë fjalë kyçe lidhur me piknikun dhe pastaj shkruajnë një tekst në të cilin përdorin fjalët kyçe. Nxënësit të ndarë në çifte, ia lexojnë njëri-tjetrit tekstet e shkruara.
- Nxënësit përshkruajnë një ngjarje të trilluar me personazhe magjike gjatë së cilës ata përdorin format foljore të kohës së shkruar.
- Nxënësit tregojnë në formën e shkruar për temën "Udhëtimi rreth Botës".
- Nxënësit tregojnë gojarisht se si e përfytyrojnë ta kalojnë pushimin veror me personazhin e tyre të preferuar (nga video lojrat, nga filmat e vizatuar, nga ndonjë tregim).
- Nxënësit lexojnë një tregim dhe pastaj e ritregojnë me gojë, kurse më vonë e ritregojnë edhe me shkrim duke ndryshuar vetën gramatikore.
- Nxënësit e dëgjojnë një tekst që e lexon mësimdhënësi, bëjnë komentimin e përmbajtjes, mandej e ritregojnë atë duke shkruar një përfundim tjetër të tregimit.
- Nxënësit e tregojnë përjetimin e tyre të tekstit që lexojnë gjatë orës nëpërmjet vizatimit të një stripi ose nëpërmjet një dramatizimi.

Fusha programore: NJOHURI MEDIATIKE DHE KULTURË E MEDIËS	
Gjithsej: 10 orë	
Rezultatet e të nxënit:	
Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë:	
<ol style="list-style-type: none"> të kërkojë, të marrë e të shfrytëzojë informacione nga media; të kuptojë dhe të transmetojë mesazhin nga një ngjarje kulturore (që ka vizituar a që është e paralajmëruar) 	
Përmbajtjet (dhe konceptet):	Standardet për vlerësim:
<ul style="list-style-type: none"> Informacione nga media 	<ul style="list-style-type: none"> Gjen informacione nga media për nevojat/interesat e veta. Veçon informacione (sipas kërkesave të parashtruara) të publikuara në media (televizion, internet, revista etj.) Shfrytëzon informacione nga media për të thurur vetë tekste për temën e caktuar.
<ul style="list-style-type: none"> Ngjarje kulturore 	<ul style="list-style-type: none"> Sqaron përmbajtjen dhe idenë e ngjarjes kulturore në të cilën ka marrë pjesë. Shpreh mendimin e vet për një ngjarje kulturore ku ka qenë i pranishëm dhe jep argumente se pse mendon ashtu. Përpilon një ftesë/afishe reklamuese për ndonjë ngjarje kulturore në shkollë ose komunitet.

Shembuj veprimtarish:

- Nxënësit vizitojnë tabelën e shpalljeve ku ndodhen lajmërimet e përditësuara të shkollës. Pastaj në çifte bisedojnë lidhur me lajmërimet që kanë lexuar (cilat informacione i kanë marrë dhe çfarë përmbanin ato informacione).
- Mësimdhënësi u jep detyra nxënësve, të ndarë në grupe, që të informohen rreth repertorit të disa teatrove në vend (secili grup nga një teatër) dhe t'i informojnë të tjerët se cilët shfaqje janë dhe kur luhen ato.
- Nxënësit në çifte hulumtojnë dhe shkruajnë receta. Fillimisht i shkruajnë përbërësit, kurse pastaj mënyrën e përgatitjes së recetës (nëse kanë interes recetat mund t'i grupojnë sipas vakteve dhe të bëjnë fletushka me receta).
- Nxënësit të ndarë në grupe, zgjedhin nga një personalitet të njohur (p.sh. sportist/sportiste, këngëtar/këngëtare, artist/artiste) për të cilin/cilën do të shkruajnë një tekst. Teksti duhet të përshkruaj disa ngjarje nga jeta e personalitetit (sipas radhitjes kronologjike) për të cilën do të informohen nëpërmjet internetit. Secili grup prezanton tekstin e vet.
- Mësimdhënësi u tregon nxënësve për turneun e futbollit të vogël që do të mbahet në shkollë, datën e vendin ku do të mbahet dhe

pjesëmarrësit. Nxënësit në çifte shkruajnë një lajmërim ose përpilojnë afishe me informatat rreth turneut që do të mbahet.

- Nxënësit në grupe përpilojnë afishe reklamuese për një shfaqje që ata e imagjinojnë.
- Nxënësve u jepet detyrë të hulumtojnë për një temë që e kanë më pak të njohur, për shembull për shenjat e trafikut. Nga hulumtimi i bërë ata mbledhin të dhëna dhe fotografi, i rregullojnë, i sqarojnë shkurtimisht para gjithë klasës.
- Nxënësit hulumtojnë për ndotjen e mjedisit ku jetojnë. Mësimdhënësi u ndihmon me material nga media elektronike, nga shtypi ditor dhe nga ndonjë blog (ditar ueb). Nxënësit i lexojnë informacionet, i radhitin, i përmbledhin, tregojnë burimin e tyre dhe i prezantojnë në grupe.
- Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe dhe u jep material për të punuar: enciklopedi të ilustruara për fëmijë, libra dhe tekste mësimore. Secili grup merr detyrë të hulumtojë të njëjtën gjë, por me informacione nga burime të ndryshme. Në fund, informacionet që kanë gjetur i këmbëjnë me grupet e tjera.
- Nxënësit vizitojnë një ekspozitë/planetariun/kopsht zoologjik dhe bëjnë regjistrime nga kjo vizitë (me telefon). Këtë material ata e përpunojnë, shkruajnë një tekst për të dhe bëjnë përpunimin video në kompjuter. Materialin e përgatitur e shpërndajnë në internet (bie fjala, në profilin facebook të klasës, në faqen ueb të shkollës).
- Nxënësit marrin pjesë në një ngjarje ku përurohet një libër, një libër me ilustrime ose një ekspozitë me piktura, kurse më pas shkruajnë një tekst të shkurtër informativ "Unë vizitova/lexova, vizito/lexo edhe ti".
- Nxënësit marrin pjesë në një koncert të ansambllit folklorik/karnaval ose në ndonjë shfaqje kulturore të vendit ku ata jetojnë. Përjetimin nga shfaqja e përshkruajnë nëpërmjet një teksti të shkurtër ose e shprehin me anë të vizatimit.
- Nxënësit të ndarë në grupe ilustrojnë kopertinën e një libri që të gjithë e kanë lexuar. Gjatë ilustrimit, ata duhet të kenë parasysh veprimet e personazheve. Ilustrimet e bëra ekspozohen në panel në hapësirën e bibliotekës ose në panel në korridoret e shkollës.
- Të ndarë në grupe nxënësit bëjnë një anketë - njëri grup anketon nxënësit e grupit tjetër. Pyetja e anketës lidhet me atë se cilin libër do t'ia rekomandonin shokut/shoqes së klasës për ta lexuar. Rezultatet e anketimit i ekspozojnë në bibliotekën e shkollës.
- Nxënësit përpilojnë rregulla për përdorimin sa më të sigurt të përmbajtjeve nga interneti.

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI NDËRKULTUROR DHE NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi siguron gjithëpërfshirjen nëpërmjet kyçjes së të gjithë nxënësve në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale me anë të qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënësit me pengesa në zhvillim zbaton planin arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënësve dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë, kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personal dhe arsimor, ndërmjetësues arsimor, mësues vullnetarë dhe profesionistë nga shkolla). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e pambrojtura, që të mund t'i identifikojë me kohë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë e t'i përkrahë ata në arritjen e rezultateve të të nxënësve.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësimdhënësi trajton njëlloj si djemtë, ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që atyre të mos u japë role me stereotipa gjinore. Gjatë formimit të grupeve të punës, mësimdhënësi përpiqet të sigurojë një balancim të bazuar në gjini. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, ai përdor ilustrime dhe shembuj të ndjeshëm në pikëpamje gjinore dhe etnike/kulturore, që nxitin barazinë gjinore, përkatësisht që promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë, kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi përdor integrimin e temave/përmbajtjeve/koncepteve. Integrimi ua mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndët e tjera mësimore në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndërlidhin njohuritë e fushave të ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'ua mundësuar nxënësve t'i arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi i ndjek vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe gjatë të nxënësve duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënësi. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informacione prapavepruese të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe jepen udhëzime për përmirësim (vlerësimi formativ). Për këtë qëllim, mësimdhënësi përcjell dhe vlerëson:

- punimet e nxënësve (krijime, rrëfime etj.);
- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimdhënësi ose nga nxënësit e tjerë;
- përgjigjet e dhëna në fletëzat e punës;
- realizimet praktike (të lexuarit, të shkruarit);
- detyrat e shtëpisë;
- përgjigjet në kontrolle dijesh (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimdhënies.

Vlerësimi sumativ kryhet në bazë të të dhënave të përgjithshme të përfituara nga përcjellja e arritjeve të nxënësit dhe nga vlerësimi formativ, duke përdorur teknika të ndryshme të vlerësimit formativ, ku mësimdhënësi konstaton (përshkruan) shkallën e zhvillimit dhe të të arriturave për çdo nxënës veçmas, në kuadër të secilës fushë programore. Në fund të vitit shkollor, nxënësi merr vlerësimin sumativ me numër.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	Viti 2021/2022	
Institucioni/bartës i programit	Byroja e zhvillimit të arsimit	Биро за развој на образованието
<p>Sipas nenit 30, paragrafi 3 i Ligjit për arsimin fillor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 161/19 dhe 229/20), ministrja e Arsimit dhe Shkencës miratoi programin mësimor të lëndës <i>Gjuhë shqipe</i> për klasën IV</p> <p>Согласно член 30, став 3 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/19 и 229/20) министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по <i>Албански јазик</i> за IV одделение.</p>	<p>бр. 08-7413/4 10.05.2021 година</p>	<p>Министерка за образование и наука, Мила Царовска, с.р.</p>